



Republika e Kosovës

Nr: _____

Me datë 08/01/2011



Komuna Vushtrri

Në bazë të nenit 12.2 paragrafi c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 10,11,13,14,15,16,17 dhe 18 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049 dhe nenit 31 .2 paragrafi a) dhe g) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë _____ mori këtë:

**PROPOZIM-VENDIM
PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR
TARIFA, NGARKESA DHE GJOBA KOMUNALE 01 Nr.742/08 TË
DATËS 30/12/2008**

Neni.1

Neni 3.1 paragrafi 9 Ceremonia e Kurorëzimit, ndryshohet prej 5 euro në 10 euro.

Neni.2

Neni 4.1 paragrafin 4 Prodhuesit e materialit ndërtimor prej 160 euro në 200 euro

-Paragrafi 1.5 Prodhuesit e mobileve prej 160 euro në 200 euro,

-Paragrafi 1.11 Bankat ekspoziturat prej 480 euro në 1000 euro,?

-Paragrafi 1.12, Këmbimoret prej 240 euro në 300 euro,

-Paragrafi 1.13 Kompanitë e sigurimeve –Filialet prej 240 euro në 300 euro,

Paragrafi 1.15 Ndërrmarrjet ndërtimore 240 euro

-Paragrafi 1.15(a) Ndërrmarrjet ndërtimore me seli në Komunën e Vushtrrisë dhe jashtë saj ,të cilat kryejnë punë në teritorin e Komunës së Vushtrrisë në lëminë e ndërtimitarisë si: ndërtimtarisë së lartë,(ndërtimi i banesave kolektive,objekteve industriale,komerciale,arsimore,e të ngjajshme përveç banimit individual) dhe ndërtimi i ultë si: instalimet nëntokësore dhe mbitokësore të rrymës,ujit,kanalizimit,telekomunikacionit,asfaltimit të rrugëve 400 euro

- Paragrafi 1.17 Depot me material ndërtimor prej 192 euro në 240 euro,

- Paragrafi 1.23 Agjencionet e shpeditacionit dhe tregjet ndryshohet në tregjet dhe sallonet e automjeteve ,

- Paragrafi 1.25 Agjencitë e sigurimit të automjeteve prej 240 euro në 300 euro.?

- Paragrafi 1.27 Agjencitë për transferimin e parave prej 160 euro në 250 euro,

- Paragrafi 1.29 Shërbimet bujqësore dhe shëndetësore, ndryshohet:

Paragrafi 1.29 (a)Barnatoret bujqësore prej 96 euro në 120 euro

Paragrafi 1.29 (b) Barnatoret veterinare dhe shërbimet 300 euro

- Paragrafi 1.30 Barnatoret shëndetësore(farmaceutike) prej 200 euro në 250 euro.

-Paragrafi 1.34 Tregtia me pakicë- Dyqanet prej 96 euro në 100 euro

-Paragrafi 1.35 Markete (prej 100-200 m2)prej 160 euro në 200 euro

-Paragrafi 1.36 Supermarkete i shtohet prej 200-1000m2 dhe prej 240 euro në 340 euro

- Paragrafi 1.37 Hipermarketet i shtohet mbi 1000m2 prej 400 euro në 600 euro.

- Paragrafi 1.52 DPT ndryshohet :Tregtia me shumicë (depot) 600 euro

- Paragrafi 1.55 Auto serviset,llokerët,autoelektricitët dhe axhustatorët prej 96 euro në 120 euro.

-Paragrafi 1.59 Metal punuesit prej 96 euro në 120 euro.

-Paragrafi 1.62 Instaluesit e rrymës,ujit prej 64 euro në 100 euro

-Paragrafi 1.63 Pishinat prej 96 euro në 100 euro,

-Paragrafi 1.64 Fushat sportive prej 96 euro në 100 euro.

-Paragrafi 1.65 Xhampresit prej 80 euro në 120 euro,

-Paragrafi 1.71 Kontrollimi teknik i automjeteve prej 192 euro në 250 euro,

-Paragrafi 1.77 Bastoret sportive -Njësitë prej 160 euro në 600 euro,

- Paragrafi 1.81 Kompanit për sigurimin fizik të objekteve dhe personave prej 192 euro në 250 euro,
- Paragrafi 2.4 Argjendarët prej 160 euro në 200 euro,
- Paragrafi 2.9 Punuesit e gurëve të varrezave prej 64 euro në 120 euro.
- Paragrafi 3.1 Ordinancat e përgjithshme prej 80 euro në 120 euro,
- Paragrafi 3.1(a) Ordinancat specialistike prej 120 euro në 200 euro,
- Paragrafi 3.2 Avokaturat prej 160 euro në 200 euro,
- Paragrafi 3.3 Noterët prej 96 euro në 200 euro,
- Paragrafi 3.4 Auditorët prej 96 euro në 200 euro,
- Paragrafi 3.5 Rëndgenët privat prej 160 euro në 200 euro,
- Paragrafi 3.6 Laboratorët mjekësor prej 160 euro në 200 euro,
- Paragrafi 3.7 Byrot projektuese prej 160 euro në 200 euro,
- Paragrafi 3.13 ndryshohet prej 10% të bazës tatimore në 30%,
- Paragrafi 3.16,3.17,3.18,3.19 dhe 3.20 hiqen nga Rregullorja.
- Paragrafi 3.16(Paragraf i ri)Bizneset në zonat rurale ngarkohen 70% nga ngarkesa bazë .
- Paragrafi 3.17(paragraf i ri)Përjashtim nga paragrafi 3.16 bëjnë bizneset për gjatë magjistrales Mitrovicë- Prishtinë.
- Paragrafi 3.18 Bizneset të cilat merren me veprimtari bujqësore me karakter prodhues ,ngarkohen me 50% nga ngarkesa bazë.
- Paragrafi 4.3 Përjashtim nga Paragrafi 4.2 bëjnë: njësit e shërbimeve postare,telefonike,bankat,bastoret sportive,pompat e benzinës dhe gazit,supermarketet dhe hipermarkete.
- Paragrafi 4.7 Subjektet afariste të cilat gjatë vitit fiskal kanë qenë pasive mund të lirohen nga taksa në bazë të dëshmive nga ATK-ja dhe kërkesës së pronarit të biznesit.
- Paragrafi 4.8(Paragraf i ri)Subjektët afariste të cilat gjatë vitit fiskal kanë pasur dëme në biznes si pasoj e fatkeqësive elementare varësisht nga dëmi mund të lirohen pjesërisht ose plotësisht nga taksa në bazë të dëshmive të organit zyrtar.
- Paragrafi 4.9(Paragraf i ri)Subjektët afarist për të cilët konstatohet se kanë kryer veprimtari afariste dhe nuk kanë qenë të ngarkuara me taksë vjetore komunale ,ngarkohen me taksë në mënyrë retroaktive konform dispozitave ligjore.
- Paragrafi 4.10(Paragraf i ri) Ankesa e ushtruar kundër Vendimit për caktimin e taksës, nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Neni 3

Neni 5.4 bartet në Drejtorin për Urbanizëm dhe Planifikim.

Neni. 4

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi qfuqizohen dipozitat përkatëse Rregullores për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoba komuale.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
z.Ferit Idrizi